

RAPORTI I DETAJUAR



I përgatitur për: Meggan Doe | MeghanDoe@Hotmail.com

I përfunduar: e hënë, Qershor 5, 2023

Qyteti: Barquisimeto

Konsulenti: demo consultant | demo_consultant@staging.careerdirect-ge.org

QËLLIMI I KËTJ INSTRUMENTI ËSHTË VETË-ZBULIMI. KY INSTRUMENT ËSHTË DIZENJUAR TË NDIHMOJË NJERËZIT TË IDENTIFIKOJNË PIKAT E FORTA TË PERSONALITETIT DHE POTENCIALIN E TYRE NË LIDHJE ME INTERESAT NË PROFESION, AFTËSITË DHE VLERAT. TEST VLERËSIMI CAREER DIRECT NUK DUHET TË PËRDORËT PËR TË IDENTIFIKUAR, DIAGNOSTIFIKUAR DHE TRAJTUAR PROBLEMET PSIKOLOGJIKE, TË SHËNDETIT MENDOR DHE ATO MJEKËSORE. PËRDORUESI POSEDON PËRGJEGJËSINË E VETME PËR ÇDO VEPRIM APO VENDIM QË MERRET SI REZULTAT I PËRDORIMIT TË KËTJ MATERIALI PËR VETËZBULIM. DUKE PËRDORUR KËTË TEST VLERËSIM CAREER DIRECT ONLINE, JU HIQNI DORË NGA ÇDO KUNDËRSHTIM QË MUND TË KENI NDAJ SHËRBESËS SË KURORËS FINANCIARE, NDONJË KOMPANIE APO SHKOLLE LIDHUR ME TË, APO NDONJË PREJ PUNONJËSVE TË TYRE QË DERIVOJNË NGA PËRDORIMI I KËTJ VLERËSIMI.

Shërbesa e Kurorës Financiare, Inc. Career Direct® Online u zhvillua nga Kurora Financiare, Inc. Sistemi i plotë udhëzues i Career Direct është një markë tregtare dhe Career Direct, logoja e Kurorës, Shërbesa e Kurorës Financiare, dhe dizenjimi i Kurorës janë marka tregtare të regjistruara me Kurorën Financiare, Inc. Të gjitha markat tregtare të tjera janë pronë të pronarëve të tyre përkatës.

Përmbajtja

Pjesa 1 Personaliteti

Koncepti i Personalitetit

- 1.1 Gjashtë Faktorët e Personalitetit
- 1.2 Pikat Kryesore të Personalitetit
- 1.3 Pikat e Forta Tipike
- 1.4 Pikat e Dobëta Tipike
- 1.5 Çështjet Kritike të Jetës

Pjesa 2 Interesat e Përgjithshme

Pesë Fushat Madhore të Interesave të Përgjithshme

- 2.1 Tetë Grupet Kryesore të Karrierës
- 2.2 Pikët e Kombinuara
- 2.3 Profesionet e Mundshme në grupet tuaja kryesore

Pjesa 3 Aftësitë dhe mundësitë

Fusha e Aftësive, kriter kyç për zgjedhjen e profesionit

- 3.1 Katër Fushat e Para
- 3.2 Vlerësoni Aftësitë Tuaja

Pjesa 4 Vlerat

Vlerat janë të rëndësishme për vendimet në karrierë

- 4.1 Mjedisi i Punës
- 4.2 Rezultatet e Punës
- 4.3 Vlerat e Jetës
- 4.4 Përmbyllje

Përmbledhje

Tabela përmbledhëse e personalitetit

Tabela përmbledhëse e interesave, aftësive, vlerave dhe profesioneve

Pjesa 5 Career Direct – Hapat Vijues

Career Direct – Hapat Vijues

Pjesa 6 Burimet

Burimet

Përdorimi i këtij raporti për Planifikimin e Karrierës



Meggan, parimi kryesor i përdorimit të këtij raporti është që njerëzit të cilët përshtasin punën e tyre me personalitetin, interesat, aftësitë dhe vlerat e përgjithshme, kënaqen dhe kanë sukses në punën e tyre. Përgjigja juaj në këto katër fusha që tregohen më poshtë do t'ju japë informacion të nevojshëm për planifikimin e karrierës. Të gjitha këto fusha duhet të merren parasysh përpara se të merrni vendimet për karrierën tuaj.

Rezultat tuaja nuk do të shpalosin një profesion të veçantë për ju. Përkundrazi, do të merrni informacion kyç që do t'ju ndihmojë të kuptoni ndërtimin tuaj unik dhe llojin e punës që do t'ju përshtatet më mirë. Qasja e përgjithshme është më e mirë, duke qenë se ka disa profesione të ngjashme që përshtaten me interesat e një personi dhe talentet e tij. Duke përdorur segmentin "Zbatimi i Career Direct" i Sistemit udhëzues, ju do të jeni në gjendje të përmirësoni mundësitë tuaja në një zgjedhje më të mirë në fushën e karrierës. Procesi i përdorimit të talenteve dhe interesave për të marrë vendime për karrierë do t'ju shërbejë mjaft mirë në menaxhimin e karrierës tani dhe në të ardhmen.

SI TË SHFRYTËZONI RAPORTIN TUAJ NË MAKSIMUM

Në këtë raport ka shumë informacion, kështu që do t'ju duhet ta lexoni disa herë. Do të përfitoni shumë nëse keni dikë, si për shembull një shok, bashkëshortin, ose një mentor që ta lexojë raportin së bashku me ju. Dikush që ka një personalitet ndryshe nga ju është një ndihmë shumë e madhe për të kapur konceptet të cilat mund t'i humbisni gjatë leximit. Nëse vendosni të takoni një konsulent për ndihmë më specifike në lidhje me planifikimin për karrierë, ky raport do t'ju japë shumë informacion për potencialin tuaj unik të karrierës. Siç e përmendëm edhe më parë, një nga hapat më të rëndësishëm për të përfituar plotësisht nga ky raport është të punoni me **Plan veprimin** në **SISTEMIN UDHËZUES TË CAREER DIRECT**.

RAPORTI I SISTEMIT UDHËZUES I CAREER DIRECT


ORGANIZIMI I RAPORTIT

Raporti është organizuar në katër fusha kryesore: Personaliteti, Interesat e përgjithshme, Aftësitë dhe Vlerat. Secila nga këto fusha ofron njohuri të rëndësishme për ndërtimin tuaj unik. Përkufizimi i të gjitha grupeve në raport mund të gjendet tek Lista përfaqësuese e profesioneve, përfshirë tek SISTEMI UDHËZUES CAREER DIRECT.

- 1. Personaliteti.** Raporti fillon me personalitetin, ku do të gjeni analizën e gjashtë faktorëve të personalitetit tek pikat tuaja të personalitetit, pikat e forta dhe pikat e dobëta tipike, dhe mjedisin e karrierës bazuar tek profili juaj unik i personalitetit.
- 2. Interesat e Përgjithshme.** Në këtë pjesë do të gjeni një renditje të interesave në 21 Grupet e përgjithshme të interesave për karrierë, dhe përshkrimin e grupeve më të rëndësishme. Këto grupime të gjera karriere janë nxjerrë nga pjesa "Inventari i interesave profesionale". Pikët tuaja pasqyrojnë nivelin e interesit në 21 Grupet e karrierës. Gjithashtu, jepet një tabelë që rendit komponentët që përbëjnë tetë interesat tuaja më të rëndësishme: Aktivitetet, Profesionet dhe Grupet e lëndëve.
- 3. Aftësitë dhe mundësitë.** Do të gjeni një renditje të aftësive tuaja në 14 fusha dhe përshkrimin e mundësive dhe aftësive tuaja më të forta.
- 4. Vlerat.** Kjo pjesë ka tre nën-pjesë: Mjedisin e punës, Rezultatet e Punës dhe Vlerat e jetës. Do të theksohen katër përparësitë më të rëndësishme në secilën fushë.

Të Kuptuarit e Shkallëve dhe Pikëve

Shkallët për të gjitha pjesët bazohen tek pikët e standardizuara, të cilat janë nxjerrë nga përgjigjet e një numri të madh njerëzish, të cilët janë të punësuar e të suksesshëm në profesione të ndryshme. Shkallët ofrojnë një mënyrë që të krahasoni vizualisht pikët tuaja me pikët e punonjësve të tjerë. Shkallët e bëjnë të lehtë të jeni në vendin e duhur. Një shembull i kësaj shkalle është dhënë dhe më poshtë.



Do të vini re në shkallën e dhënë si shembull lart, që ato rezultate midis +5 dhe +30 në të djathtë dhe në të majtë janë interpretuar si të larta. Rezultatet midis +5 në të djathtë dhe +5 në të majtë janë konsideruar Mesatare. Këto rezultate nuk nënkuptojnë arritje apo pikë "të mira" apo "të këqija". Ato përfaqësojnë ku qëndron ti në shkallën matëse, duke nënkuptuar sjelljen tuaj të natyrshme. Sa më shumë që tenton të shkosh majtas apo djathtas, aq më ekstreme do të jetë sjellja juaj përkundrejt dimensioneve specifike.



Në grafikun e shiritit të shembullit të mësipërm, rezultatet e shfaqura janë për interesat dhe aftësitë/aftësitë. Grafiku tregon një interes të ulët (majtas), një interes të moderuar (të mesëm) dhe interes të lartë (djathtas). Këto pikë nuk tregojnë arritje ose nuk janë pikë 'të mira' apo 'të këqija'. Ato tregojnë se ku qëndroni ju mesatarisht, bazuar tek përgjigjet që ju keni dhënë, në lidhje me njerëzit e tjerë në kategorinë e të rriturve apo të rinjve.

Koncepti i Personalitetit


Meggan, në këtë pjesë, termi personalitet përshkruan mënyrën se si një person është i motivuar të veprojë natyrshëm. Për shembull, disa njerëz e kanë të lindur motivin për të qënë tepër të organizuar dhe precizë dhe disa të tjerë janë më tepër spontanë dhe të thjeshtë. Disa të tjerë marrin rrezeqë përsipër dhe disa janë më të kujdesshëm nga natyra.

Eksperienca dhe vëzhgimi tregojnë se nuk ka ndonjë lloj personaliteti që është më i miri. Secili lloj është i mirë. Secili është i nevojshëm në shoqëri dhe në vendin e punës. Secili ka pika të forta dhe të dobëta.

Është shumë e rëndësishme të keni parasysh stilin tuaj të personalitetit kur merrni vendimet për karrierë. Qëllimi është të dalloni profesione që lidhen mjaft mirë me prirjet tuaja të lindura, po kështu dhe me interesat, aftësitë dhe vlerat. Ashtu si një trajner ka nevojë për një atlet që është i përmasave të ndryshme dhe me shpejtësi të ndryshme për të luajtur në pozicione të ndryshme, punëdhënësit kanë nevojë për stile të ndryshme personaliteti për të ndërtuar grupe të suksesshme.

1.1 Gjashtë Faktorët e Personalitetit

Ky studim i personalitetit mbulon gjashtë faktorët më të rëndësishëm të personalitetit.



Kur flasim për personalitetin, nuk është e thënë se duhet të jeni kështu apo ashtu (për shembull, ekstrovert apo introvert). Një person duhet të përdorë fuqitë e tij që shoqërojnë personalitetin e tij unik.

Këta faktorë janë nxjerrë nga kërkime të thella dhe janë në përputhje me matjet e tjera të tipareve normale të personalitetit.

Secili faktor është i lidhur me disa sjellje. Për shembull, njerëzit që kanë marrë pikë në të qenit ekstrovert (një person që merr energji nga koha me të tjerët) kanë një reagim krejt ndryshe kur takojnë njerëz të panjohur krahasur me ata që kanë pikë të larta në të qenit introvert (një person që merr energji kur kalon kohë vetëm). Ata që kanë pikë mesatare shfaqin sjellje të përziera. Ndërsa lexoni këtë seksion, mos harroni se të gjitha pikët në shkallë, kanë pika të forta dhe pika të dobta.

DUKE KONFIRMUAR PËRGJIGJEN TUJ NË PJESËN E PERSONALITETIT


Kjo pjesë e raportit tuaj, si edhe pjesa tjetër e raportit, është zhvilluar nga përgjigjet që ju keni dhënë dhe pasqyron profilet që janë tipike për njerëzit që kanë të njëjtat pikë si ju. Raportet janë në përgjithësi të sakta, por jo çdo gjë mund të aplikohet për ju. Do t'ju duhet të konfirmoni informacionin që ju është dhënë. Shikojeni raportin bazuar nga ajo që ju dini në lidhje me veten tuaj, dhe kërkojini personit që po ju ndihmon, që të kontrollojë përgjigjen tuaj gjithashtu. Përqëndrohuni tek pjesët që ju përshkruajnë ju më mirë.

1.2 PIKAT TUAJA KRYESORE TË PERSONALITETIT

Meggan, tre faqet në vazhdim renditin gjashtë faktorët e personalitetit tuaj. Ato janë rradhitur nga ato më të theksuara në ato më pak të theksuara.

1. Aventurier

Aventurier, ambicioz, konkurrues dhe i tërhequr prej sfidave.



Ndikimet e Karrierës

Me pikët e larta tek faktori i **AVENTURIERËS**, puna juaj duhet të përfshijë mundësinë për të:

- ✓ udhëhequr
- ✓ marrë rreziqe përsipër
- ✓ konkurruar
- ✓ arritur qëllime të larta
- ✓ kërkuar aventura të reja
- ✓ filluar projekte të reja.

Rezultati juaj në shkallën e AVENTURIERËS tregon se prireni drejt sfidave të reja. Ndhieni rehat kur ndërmerrni aktivitete të cilat kërkojnë edhe rrezikshmëri. Shpirti juaj pioner ju bën të ecni përpara në fusha të reja me shumë pak hezitim.


Një nga pikat tuaja më të forta është niveli i lartë i kurajos dhe iniciativës. Arritja është tepër e rëndësishme për ju. E gjeni veten duke vendosur qëllime të larta dhe më pas e shtyni veten drejt suksesit. Me ambicie të larta dhe një shpirt tepër konkurrues, natyrshëm e shtyni veten drejt rezultateve që mund t'i shihni dhe masni. Ju ndoshta preferoni të fitoni në çdo sfidë që ndërmerrni.

Dobësitë që mund të jenë të pranishme janë zakonisht rezultat i tejkalimit të pikave të forta që shoqërojnë këtë dimension. Për shembull, mund të jeni tepër konkurrues saqë manipuloni të tjerët në mënyrë që të fitoni dhe të arrini atë që është e rëndësishme për ju.

Gjithashtu, vetësiguria e natyrshme që keni në aftësinë tuaj për të qënë i suksesshëm, mund t'ju çojë të mendoni se keni të drejtë në çdo gjë. Të paturit këshilltarë që nuk bien dakord dhe japin anën tjetër të çështjeve do t'ju ndihmonte të vlerësonit vendimet me kujdes. Së fundmi, do të jeni më tepër efektivë duke ekuilibruar guximin natyror me një masë maturie.

2. I dhembshur

I mëshirshëm, i ndjeshëm, dhe një dëgjues i mirë; i durueshëm, besnik, mbështetës dhe inkurajues ndaj të tjerëve.



Ndikimet e Karrierës

Rezultati juaj tek faktori i **DHEMBSHURISË** është relativisht i lart. Kërkoni për profesione që ju lejojnë të mbështesni njerëzit në mjedise miqësore dhe përpiquni të rrii larg atyre që kërkojnë nga ju të përballeni me të tjerët apo të merrni me grindje a refuzime të herë pas hershme. Në mjedisin tuaj ideal të punës kërkoni për profesione që përfshijnë:

- ✓ mirësinë
- ✓ tolerancën
- ✓ një nivel të lartë besimi
- ✓ stabilitet
- ✓ harmoni
- ✓ mundësinë për të ndihmuar të tjerët.


Pikët që keni marrë tek shkalla e DHEMBSHURISË tregojnë se jeni një person i dhembshur dhe i kuptueshëm. Ndjeshmëria juaj ju jep mundësi të përshtateni ndaj dhimbjes dhe të luftoni për ata që ju rrethojnë. Si një dëgjues i duruar dhe jo gjykues, mund të keni një ndikim të thellë tek të tjerët, sidomos në situatat një me një.

Duke qenë se njerëzit kuptojnë shqetësimin tuaj të sinqertë dhe sjelljen e kujdesshme, ata në mënyrë të natyrshme duan të hapin zemrën me ju. Në këto raste do të jetë e natyrshme për ju të inkurajoni dhe këshilloni të tjerët.

Personaliteti juaj i këndshëm e bën shumë të thjeshtë të përshatni lehtë në çdo mjedis, për aq kohë sa ka harmoni. Konfliktet ju sjellin stres, prandaj rekomandohet të shqyrtoni me kujdes organizatën apo grupin e punës që jeni duke marrë në konsideratë përpara se të bashkoheni me to.

3. KRIJUESHMËRISË

Tepër krijues. Ju pëlqen në veçanti të shprehni ide të reja dhe të kërkonit sfida mendore.



Ndikimet e Karrierës

Duke marrë parasysh pikët që keni marrë në faktorin e **RISISË**, kërkonit për mundësitë në profesionin tuaj:

- që ju japin liri për të qenë krijues
- që sigurojnë sfida intelektuale
- ku mund të punoni me idetë
- që japin kohë për të menduar/reflektuar
- ku merreni me koncepte abstrakte
- për t'u shprehur në mënyrë artistike.


Meggan, rezultati juaj tek shkalla e RISISË tregon se jeni një person tepër krijues. Shquheni në gjenerimin e zgjidhjeve të reja dhe ideve, edhe pse për të tjerët mund të duket disi e pazakontë. Mund ta gjeni veten duke ëndërruar apo duke i konsideruar idetë nga këndvështrime të ndryshme. Mund ta shprehni krijueshmërinë tuaj në mënyra të ndryshme, duke përdorur logjikën në zgjidhjen e problemeve, duke punuar me duart, ose në shumë sipërmarrje artistike, siç është të shkruarit, muzika, drama, apo artet vizuale.

Keni dhunti për të qenë i zgjuar dhe i shkathët. Është e natyrshme për ju të kërkonit sfida mendore. Ju pëlqen të mendoni, e bëni si një formë argëtimi, dhe është mjaft lehtë për mendjen tuaj të analizojë tema si në thellësi ashtu dhe gjerësi.

Ndërsa krijueshmëria dhe imagjinata janë mjete të forta në shumë situata, ato mund të humbin nëse nuk merren hapa praktike për të zbatuar ide të reja. Mund të luftoni me mbajtjen e fokusit dhe ndjekjen e projekteve që keni nisur. Mund të harroni çështjet e përditshme, praktike. Mbajtja e një listë, duke qenë i disiplinuar me afate, dhe një përkushtim të fortë ndaj përgjegjshmërisë mund të përmirësojë frytshmërinë tuaj.

4. Ekstrovert

Shumë shoqëror, i orientuar rreth njerëzve, kënaqeni duke takuar njerëz të rinj; entuziast dhe i mirë për të lidhur njerëzit bashkë (networking).



Ndikimet e Karrierës

Bazuar në rezultatin tuaj në fushën e **EKSTROVERSIONIT**, ju përshtateni mjaft mirë me profesione të orientuara ndaj njerëzve. Kërkonit për një mjedis pune që do t'ju lejojë të lidheni me njerëzit në një mënyrë miqësore dhe t'ju japin mundësinë për të:

- biseduar/shpjeguar
- për t'u promovuar
- nxituri
- performuar
- lidhur të tjerët (network)
- përdorur humorin.


Rezultati juaj tek shkalla e EKSTROVERSIONIT është tipike për ata që kërkojnë ndërveprim të shpeshtë me njerëzit dhe kanë aftësi të forta verbale. Niveli i lartë i energjisë është pak a shumë i dukshëm nga gjestet, entuziazmi në bisedë, dhe buzëqeshja e vazhdueshme ndërsa komunikoni me të tjerët. Sfidoheni nga mundësitë për të qenë këmbëngulës dhe bindës, dhe lini një përshtypje pozitiv në grupe të mëdha. Si një person i orientuar ndaj njerëzve, keni pritje të mëdha për mundësitë që ofron rrjeti, që dalin nga ngjarje si konventat, bashkimet, takimet, festat, dhe aktivitete sociale të ngjashme me këto.

Një fushë tjetër e fortë për ju është stili juaj spontan dhe i papërmbytur. Ju nuk jeni i druajtur dhe ka të ngjarë që keni dhunti për të përfshirë njerëz të rezervuar/turpshëm në aktivitete grupi. Merrni energji nga mundësia që keni për të folur dhe performuar përpara një audience.

Meggan, mos harroni se një pikë e fortë e mbipërdorur mund të kthehet në një pikë të dobët. Aftësitë tuaja verbale janë një pasuri e vërtetë, por është mënyra e dini se kur duhet të heshtni dhe dëgjoni. Të qenit i vëmendshëm sesi të tjerët e presin bisedën tuaj, do t'ju ndihmojë të merrni në konsideratë interesat e tyre dhe bisedat për të cilat kanë nevojë. Për efektivitet maksimal, konsiderojini të tjerët rreth jush dhe përshtateni sjelljen tuaj sipas situatës.

5. Dominues

Guximtar, vetëmbështetës, i pavarur, i orientuar drejt rezultateve dhe në mënyrë të natyrshme dëshironi të merrni rolin e udhëheqësit.



Ndikimet e Karrierës

Për të kënaqur/përmbushur etjen tuaj për **DOMINIM**, kërkonte për mundësitë për të:

- qenë në krye (nën kontroll)
- planifikuar për të ardhmen
- folur drejtpërdrejt
- hedhur ide të reja
- influencuar të tjerët
- marrë vendime.

Meggan, rezultati juaj tek shkalla e MBIZOTËRIMIT tregon se jeni natyrshëm i motivuar për të qenë në kontroll të mjedisit tuaj. Kjo tendencë për dominim ndoshta shprehet në shumë mënyra në jetën tuaj. Pavarsisht nëse është të ngarit makinë, planifikim pushimesh, apo vendosje prioritesh në punë, natyrshëm i besoni vetes më tepër se kujtdo tjetër dhe dëshironi të jeni në kontroll. Mund të keni vëne re se përpigëni të shmangni situatat në të cilat ju jeni të kufizuar nga axhenda e dikujt tjetër.


Konfidenca juaj, natyra vendimtare, ju bën të përshtateni mjaft mirë në rolet e udhëheqësisë. Keni një dëshirë të natyrshme të ndikoni të tjerët, dhe kjo mund të shërbejë në suksesin tuaj në politikë, shitje, dhe profesione të ngjashme. Shumica e njerëzve që kapin pikë të larta tek MBIZOTËRIMI, veprojnë nga një këndveshtrim i një pamjeje të madhe. Kjo ju jep një aftësi unike për të parashikuar ndryshimet dhe për të konceptualizuar idetë e reja për të vepruar në të ardhmen. Kjo dhunti 'vizionare' është një nga pikat tuaja të forta.

Keni një prirje të fortë për pavarësi dhe ndoshta keni idetë tuaja në lidhje me atë sesi duhet të bëhen gjërat. Është e natyrshme për ju të flisni për idetë tuaja dhe opinionet.

Ka disa pika të dobëta që i kanë të përbashkët ata që natyrshëm marrin kontroll. Për shkak të dëshirës për të qenë në kontroll, mund të gjeni veten të përfshirë në punë për të cilat nuk keni ekspertizë të mjaftueshme apo fakte. Gjithashtu, mos harroni se ju prireni për të minimizuar apo anashkaluar detajet e punës të nevojshme për të realizuar idetë madhështore që keni. Në përgjithësi, një qasje më e kujdesshme dhe të dëgjuarit e një këshille të shëndoshë nga dikush që është e kundërta me ju në personalitet do t'ju ndihmojë shumë.

6. I pastrukturuar / I ndërgjegjshëm (Mesatare)

I strukturuar në disa fusha dhe veproni spontanisht me të tjerët.



Ndikimet e Karrierës

Rezultati juaj i mesëm tek faktori i **NDËRGJEGJSHMËRISË**, tregon se ju pëlqen struktura disi, por gjithashtu ju pëlqen dhe spontaniteti. Dëshironi të jeni i përgatitur, por ndiheni rahat kur jepni përgjigje spontane kur është e nevojshme. Duke marrë në konsideratë fusha të ndryshme të karrierës, kërkonte për profesione që ofrojnë ekuilibër dhe mund të përshkruhen si:

- i strukturuar por jo shumë i ngurtë
- në përputhje, por me një larmi
- i parashikueshëm por me disa mundësi për të qenë spontan
- të detajuara, por me një mundësi për të punuar çështje më të gjera.

Pikët mesatare që keni marrë tek shkalla e NDËRGJEGJSHMËRISË tregojnë se keni kapacitet për të qenë preciz dhe jo i shqetësuar. Ndërsa ekzaminoni stilin e jetës dhe zakonet e punës suaj, ka gjasa të zbuloni disa fusha tek të cilat jeni tepër i organizuar, i plotë dhe i saktë. Ndoshta ndodh që ju mbroni disa metoda dhe ide tuaja në mënyrë të ngurtë, duke quajtur kompromisin si të papëlqyeshëm.

Megjithatë, në fusha të tjera, ju mund të jeni i lumtur, i lirshëm, dhe të mos iu kushtoni vëmendje detajeve. Mund të zbuloni se i bëni rezistencë strukturës, rregullave dhe procedurave të vendosura në mënyrë që të kaloni në një drejtim tjetër.

Për shkak të ekuilibrit tek ky dimension, shumëllojshmëria përshkruan mjaft mirë nivelin e ndërgjegjes në jetën tuaj. Spontaniteti dhe kurioziteti juaj mund të kompesohen mjaft mirë me kujdesin dhe hezitimin që keni. Arsyeja është e thjeshtë: Sipas pikëpamjes tuaj, disa sfera të aktivitetit kërkojnë më tepër vëmendje dhe kujdes se disa të tjera.

Fleksibiliteti juaj, kombinuar me një përkushtim të vazhdueshëm ndaj shkëlqyeshmërisë, mund të prodhojnë rezultate të paimagjinueshme, në mënyrë të veçantë kur shkruani qëllimet tuaja dhe hartoni një plan të mirëmenduar për të bërë që ai të zbatohet.

1.3 Pikat e Forta Tipike

Meggan, më poshtë janë pikat e forta tipike për njerëzit që kanë pikë të ngjashme me tuajat. Kërkoni për profesione që do t'ju lejojnë t'i theksoni këto pika të forta. Sa më shumë të jeni në gjendje t'i përdorni këto pika të forta në punë, aq më shumë do të keni sukses dhe kënaqësi. Siç e përmendëm dhe më lart, do t'ju duhet t'i kontrolloni me dikë që ju njeh shumë mirë për të konfirmuar nëse të gjitha sa më poshtë janë të aplikueshme për ju.

- I orientuar drejt udhëheqësisë, në mënyrë të natyrshme ju pëlqen të influenconi të tjerët dhe të jeni në kontroll.
- Diplomatik në marrëdhënie me të tjerët.
- Mbështeteni tek vetja; me besim në aftësitë tuaja.
- Energjik, pozitiv, dhe entuziast; ju pëlqen të përfshiheni në shumë aktivitete.
- I shoqërueshëm, përziheni kollaj; merrni energji nga takimet me njerëz të rinj.
- Keni pikë të fortë inkurajimin e të tjerëve.
- I ndjeshëm dhe i dhembshur me të tjerët.
- I pëlqyeshëm; shkoni shumë mirë me të tjerët.
- Tepër i vendosur për të arritur qëllimet.
- Veproni nga një perspektivë gjeneraliste.
- Ambicioz dhe oportunist; një etje e madhe për të arritur dhe për të pasur sukses.
- Nismëtar; kënaqeni ndërsa ndërmerrni një rrezik të llogaritur.
- I qetë dhe i sigurt në përballje me fatkeqësitë dhe vështirësitë.
- Mëndjemprehtë, i shkathët; në gjendje të kapni koncepte abstrakte.
- I zgjuar në gjetjen e zgjidhjeve dhe përgjigjeve ndaj problemeve.
- Krijues, me shumë imangjinate, dhe origjinal; i mirë për të sjellë ide të reja.


1.4 Pikat e Dobëta Tipike

Më poshtë janë pikat e dobëta, tipike për njerëzit që kanë të njëjtat pikë si ju. Përmirësimi në këto fusha do të rrisë performancën tuaj. Nga ana tjetër, përpiquni të minimizoni ekspozimin në fushat që nuk janë pikat tuaja të forta. Siç e përmendëm më parë, do t'ju duhet t'i kontrolloni me dikë që ju njih shumë mirë për të konfirmuar nëse të gjitha janë të aplikueshme për ju.

- Mund të jeni shtytës më shumë se ç'duhet për të arritur rezultatet.
- Mund të mos i jepni mendimet e vërteta.
- Harroni se suksesi është përpjekje grupi.
- Mund të jeni tepër optimist për rezultatet dhe njerëzit.
- Mund të keni problem me menaxhimin e kohës dhe të mbajturit e bisedës të fokusuar.
- Vështirësi për t'u thënë 'JO' të tjerëve.
- Mund të jeni tepër i besueshëm, duke i lejuar të tjerët të përfitojnë nga situata.
- Mund të stresoheni nga konflikti dhe nuk ju pëlqen konfrontimi.
- Mund të zhyteni aq shumë në punë sa që neglizhoni shëndetin, familjen dhe nevojat e të tjerëve.
- Mund të mos vini re fakte të rëndësishme; mund të dilni tepër shpejt në konkluzione.
- Prirje për t'u fokusuar më tepër se ç'duhet në qëllimet personale dhe mund të sakrifikoni familjen për hir të suksesit.
- Mund të merrni rreziqe të panevojshme.
- Mund të keni një qëndrim superioriteti.
- Mërziteni shpejt me procedurat e vendosura.

1.5 Çështjet Kritike të Jetës

Kjo pjesë ofron njohuri që do t'ju ndihmojnë të zgjidhni një karrierë në të cilën mjedisi, lidhet me pikat e forta të personalitetit tuaj.



Stresi

Rezulati juaj tek shkalla e STRESIT tregon se niveli juaj i stresit është pothuajse i njëjtë siç përjetohet nga pjesa mesatare e njerëzve në shoqëri. Mos harroni se ky instrument nuk është dizenuar për të identifikuar apo trajtuar probleme psikologjike. Nëse ndiheni se keni nevojë për ndihmë në disa fusha, kontaktoni me një profesionist për vlerësim diagnostik.

Borxhi

Përgjigjet tuaja tregojnë se ju keni një nivel mbi mestaren përsa i përket të paturit borxhe. Të jetuarit me një buxhet, duke planifikuar për shpenzimet dhe kursimet tuaja, bazuar në të ardhurat që keni, do të ndihmonte shumë situatën tuaj. Eksperiencat kanë treguar se shumica e njerëzve mund të paguajnë borxhin konsumator (çdo gjë përveç kredisë së shtëpisë) në më pak se pesë vjet, nëse do të marrin një përkushtim për ta bërë këtë gjë.

Menaxhimi financiar

Duket se jetoni me një plan financiar të shëndetshëm. Ka të ngjarë që ju kontrolloni shpenzimet nëpërmjet një buxheti, keni një program të rregullt kursimesh dhe në të njëjtën kohë një plan investimi për të mbuluar të papriturat e së ardhmes.

Pesë Fushat Madhore të Interesave të Përgjithshme

Meggan, zbulimi i interesave të përgjithshme është një hap kritik në procesin e planifikimit të karrierës për arsyen e thjeshtë se: Njerëzit përpiqen të shkëlqejnë kur janë të interesuar në punën që bëjnë! Ajo që mund t'i duket detyrë e vështirë një personi, mund t'i duket e lehtë dhe e këndshme një tjetri që është i motivuar drejt asaj lloj pune. Në përgjithësi, punën që ju intereson, do ta bënit me qejf edhe nëse do të kishte të bënte me detyra që nën rrethana të tjera do të ishin të vështira apo të mërzitshme.


Për shkak të natyrës së interesave tuaj, ndjekja e aktiviteteve në kohën e lirë mund të ketë ndikuar pikët e Interesave tuaja të Përgjithshme. Kjo do të thotë se duhet të vini në punë zgjuarsinë kur interpretoni seksionin e raportit, Interesat e përgjithshme.

Për shembull, nëse të pëlqejnë ushtrimet fizike dhe sportet, "Sportet dhe ushtrimet fizike" mund të shfaqen si një Grup Karriere i lartë. Megjithatë, meqë pak individë bëhen atletë profesionistë, bëni dallimin mes rezultatit të lartë për atë që ka të ngjarë të jetë: diçka që do ta bëni për t'u argëtuar dhe për t'u zbatimur, por jo për një karrierë.

Nga ana tjetër, Meggan, sa më shumë që ju përshtatni punën me fushat që ju sjellin kënaqësi, aq më e lartë është mundësia për të patur sukses. Një person që pëlqen të gjuajë shtiza dhe shigjeta bëhet shitësi numër një për një kompani harqesh, duke ndjekur interesin e madh që ka për hedhjen e shtizës. Për më tepër, shumë njerëz zhvillojnë biznese të suksesshme nisur nga hobet e tyre. Mbani mend, sa më shumë që të kënaqeni me atë që po bëni, aq më tepër do të kënaqeni me punën tuaj, dhe aq më i ulët do të jetë niveli juaj i stresit.






Ka një numër mënyrash për të kategorizuar interesin e karrierës. Ky raport përdor 21 Grupe të Interesit të Karrierës të renditura brenda pesë fushave kryesore të Interesit të Karrierës. Këto pesë fusha të mëdha të Interesit të Karrierës janë shfaqur në grafikun e rrethit më poshtë, duke treguar se si 8 kategoritë më të larta tek Grupet e Interesit të Karrierës bien brenda tyre. Nëse keni më pak se pesë fusha kryesore të interesit të karrierës, kjo do të thotë se asnjë nga 8 grupet tuaja kryesore të Interesit të Karrierës nuk bien brenda asaj zone. Më shumë hollësi rreth ndarjes brenda këtyre pesë zonave kryesore mund të gjenden në faqet vijuese.

Fushat Kryesore të Interesave dhe Grupet e Karrierës



Pesë Fushat Madhore të Interesave të Përgjithshme

Në grafikët më poshtë, në qoftë se ju keni ndonjë fushë që tregon 0%, kjo është për shkak se asnjë nga 8 grupet tuaja më të larta tek Grupet e Interesit të Karrierës nuk bien brenda Zonave të Mëdha të Interesit. Megjithatë, ju do të keni ende të dhëna interesi që shfaqen atje.




2.1 Tetë Grupet Kryesore të Karrierës

Tre përbërës, Aktivitetet, Profesionet dhe Lëndët Arsimore, përcaktojnë rezultatet e grupit tuaj të karrierës. Këto interesa mund të jenë të lidhura me punën ose kohën e lirë, ose mund të jenë zbatimje ose hobi që mund të përdoren si bazë për një karrierë. Meqë Grupet e Karrierës janë të përbërë nga disa pjesë, mund të zbuloni se një grup Aktiviteti mund të jetë shumë i rëndësishëm për ju, por përbërësit e tjerë të grupit mund të mos jenë të rëndësishëm për ju. Rrjedhimisht, interesi juaj kryesor nuk është i lartë në listën e Grupeve të Karrierës. Për shembull, ju mund të kënaqeni me matematikën, por nuk ju intereson financa, kështu që rezultati juaj në Grupet e Karrierës, Kontabilitet/Financiare, nuk është i lartë.

Më poshtë jepen përgjigjet e detajuara në lidhje me pikët e grupit tuaj të karrierës. Për secilën kategori të interesit, jepen pikët tuaja tek përbërësit: Aktivitetet, Profesionet dhe Lëndët.


Shënim: Të gjitha grupet kanë Aktivitete, por jo të gjitha përmbajnë Profesionet dhe Grupet e lëndëve.



Ky grup karriere përfshin një dëshirë të fortë për të udhëtuar ose punuar në një vend të huaj, për të kuptuar dhe për të bashkëpunuar me njerëz nga kultura të tjera, dhe/ose për të komunikuar në më shumë se një gjuhë. Kjo fushë përfshin aktivitete të tilla si puna për të krijuar një mjedis gjithpërfshirës dhe të larmishëm, bashkëpunimin dhe punën me njerëz nga kultura të ndryshme, ose mësimin e një gjuhe të huaj. Profesionet tipike të lidhura me këtë grup karriere përfshijnë:

- ✓ Agjent i Shërbimit të Huaj
- ✓ Mësues i Gjuhës së Huaj
- ✓ Përkthyes tekstesh, librash/Përkthyes simultant
- ✓ Stjuardesë
- ✓ Diplomati/Ambasador
- ✓ Guidë turistike/Agjent Udhëtimi
- ✓ Ekzekutiv Ndërkombëtar i Biznesit
- ✓ Oficer i Kombeve të Bashkuara
- ✓ Gazetar/Korrespondent i huaj jashtë vendit


Përgatitja në këtë fushë mund të përfshijë studime ndër-kulturore, antropologji, sociologji, psikologji, ekonomi, shkenca politike, dhe/ose gjuhësi.



Ky grup karriere përfshin shprehjen e ideve nëpërmjet krijimit të veprave origjinale të artit. Kjo fushë përfshin aktivitete të tilla si vizatimi, projektimi i objekteve përmes artit grafik, planifikimi dhe projektimi i mjediseve të brendshme, skulpturimi, projektimi i seteve të teatrit dhe projektimi i efekteve vizuale. Profesionet tipike të lidhura me këtë grup karriere përfshijnë:

- ✓ Dizajner Grafik
- ✓ Dizajner i Përbajtjes Dixhitale
- ✓ Arkitekt Peisazhi
- ✓ Stilist
- ✓ Arredues i Brendshëm
- ✓ Artist
- ✓ Skulptor/Argjendar
- ✓ Skenograf teatri
- ✓ Fotograf


Arsimi në këtë fushë, mund të përfshijë kurse në art, vizatim, historinë e artit, artin grafik të kompjuterizuar, dizajnin e brendshëm, skulpturën ose fotografinë.



Ky grup karriere përfshin të punuarit me njerëzit dhe të ndihmsh të tjerët të mësojnë aftësi të reja ose të zotërojnë ide të reja. Kjo fushë përfshin aktivitete të tilla si sigurimi i mësimit në fusha të ndryshme, drejtimi i veprimtarive arsimore, zhvillimi dhe/ose përgatitja e materialit arsimor (duke përfshirë planet mësimore), testimi, ose mbikëqyrjen e administrimit të një shkolle. Profesionet tipike të lidhura me këtë grup karriere përfshijnë:

- ✓ Instruktor i tregtisë
- ✓ Trajnues i korporatës
- ✓ Drejtor i shkollës
- ✓ Administrator i Arsimit të Lartë
- ✓ Profesor
- ✓ Specialist i Arsimit
- ✓ Mësues asistent/Ndihmës mësues në klasë
- ✓ Hartues i Kurrikulës Dixhitale (online ose në klasë)
- ✓ Pedagog/Mësues privat


Përgatitja në këtë fushë shpesh kërkon një diplomë universiteti, për ata që kanë nevojë për shkollim të mëtejshëm, të tilla si një diplomë master në arsimin fillor, të mesëm, ose të lartë.



Ky grup karriere përfshin aktivitete të lidhura me biznesin, të tilla si menaxhimi i projekteve dhe/ose njerëzve, si dhe pronësia ose drejtimi i një biznesi. Kjo fushë përfshin aktivitete të tilla si analizimi i operacioneve dhe krijimi i sistemeve, delegimi, bashkëveprimi me njerëzit, koordinimi i projekteve, pajisjet e zyrave operative, ose shërbimi i organizatave jofitimprurëse duke mbledhur para ose duke u kujdesur për komunitetin. Profesionet tipike të lidhura me këtë grup karriere përfshijnë:

- ✓ Nëpunës banke
- ✓ Bashkëpunëtor i shitjeve me pakicë
- ✓ Asistent Administrativ
- ✓ Asistent Ekzekutiv
- ✓ Analist i shërbimit teknik
- ✓ Koordinator programi ose projekti
- ✓ Menaxhues Zyrash
- ✓ Avokat i Organizatave bamirëse jofitimprurëse/jo-qeveritare (OJQ)
- ✓ Receptonist tek sporteli (përsëhendtja dhe orientimi i mysafirëve/klientëve, caktimi i takimeve, u përgjigjesh telefonave)


Përgatitja në këtë fushë mund të përfshijë menaxhimin e biznesit, administrimin, komunikimin, dhe burimet njerëzore.



Ky grup karriere përfshin argëtimin dhe/ose komunikimin nëpërmjet prezantimeve të talentit artistik dhe/ose nëpërmjet komunikimit me shkrim ose verbal për informacion, frymëzim, ose argëtim. Profesionet tipike të lidhura me këtë grup karriere përfshijnë:

- ✓ Këngëtar/Valltar/Model
- ✓ Moderator në Radio/TV /Podcast
- ✓ Producent/Regjisor
- ✓ Muzikant/Dirigjent muzike
- ✓ Teknikë audio/video
- ✓ Aktor/Aktore/Komedian
- ✓ Kameraman në Televizion, për Video/Filma
- ✓ Analistë të lajmeve, Gazetarët/Reporterët
- ✓ Autor/Shkrimtar (libër, blog, përmbajtje web, media sociale)

Shkollimi në këtë fushë mund të përfshijë shkrimin dhe komunikimin, muzikën, kërcimin, artet e bukura dhe/ose dizajnin.



Ky grup karriere fokusohet në zgjidhjen e problemeve komplekse duke përdorur formula matematikore ose financiare, koncepte dhe softuerë. Kjo fushë përfshin aktivitete të tilla si përgatitja e kthimit të taksave për klientët, analizimi i formulave matematikore, krijimi dhe balancimi i buxheteve, ose përdorimi i statistikave. Profesionet tipike të lidhura me këtë grup karriere përfshijnë:


- ✓ Programues Programesh Kompjuterikë
- ✓ Ekonomist
- ✓ Llogaritar
- ✓ Bankier/Oficer kredie
- ✓ Statisticien
- ✓ Analist i të dhënave
- ✓ Analist financiar/i investimeve
- ✓ Planifikues/Këshillues Financiar
- ✓ Inspektor/Llogaritar

Përgatitja në këtë fushë mund të përfshijë kontabilitetin, financën, statistikat, matematikën, shkencat kompjuterike ose ekonominë.


2.2 Pikët e Kombinuara

Tabela më poshtë përmban pikët tuaja standarde aktuale për Aktivitetet, Profesionet dhe Grupet e lëndëve. Këto janë kategoritë që përbëjnë fushat e Interesit të përgjithshëm që janë dhënë në faqet e fundit. Grafikët tregojnë interes të ulët (majtas), interes të moderuar (mesatar) dhe interes të lartë (djathtas) Mos harroni se këto janë pikët e interesit dhe nuk marrin parasysh eksperiencat dhe aftësitë tuaja.


Grupet e Aktiviteteve



Grupet e Profesioneve



Grupet Tematikë



2.3 Profesionet e Mundshme në grupet tuaja kryesore

Meggan, Tetë grupet kryesore të karrierës të përshkruara në faqen e mëparshme japin përkufizimet e përgjithshme për grupet e gjera të profesioneve për të cilat jeni më i interesuar. Disa nga përshkrimet dhe profesionet tek këto grupe mund të mos jenë tërheqëse për ju. Nuk ka problem, vetëm mbani shënim ato që nuk ju pëlqejnë dhe përdorini si kriter për të ngushtuar interesin tuaj për karrierë. Pa dyshim, në këtë proces do t'ju ndihmojë informacioni në pjesët e tjera të këtij raporti, dhe pjesët "Zbatimi i Career Direct" dhe "Burimet e Career Direct".


Lista e detajuar e profesioneve në këtë dhe grupet e tjera tregohen në Listën Përfaqësuese të Profesioneve që shoqëron test-vlerësimin Career Direct. Në Listën përfaqësuese të profesioneve janë 1,600 profesione, të grupuara në pesë fusha madhore të interesit të përgjithshëm (Të bërit, Të ndihmuarit, Të influencuarit, Të analizuarit dhe Të shprehurit). Këto kategori të gjera të karrierës, organizohen në 21 Grupet e interesit të përgjithshëm të karrierës, (si në raportin tuaj), dhe një numër grupimesh të karrierës.

MBANI SHËNIM GRUPET TUAJA ME INTERES MË TË ULËT


Është e rëndësishme që të mbani shënim katër grupet me interes më të ulët. Janë të renditura tek tabela më poshtë. Fushat me pikët më të ulëta mund të zbulojnë disa të dhëna për interesat tuaj për karrierë.



Prodhojnë produkte, koordinojnë operacione komplekse, ofrojnë shërbime transporti dhe shpërndarjeje.



Kryen kërkime shkencore, studion proceset fizike ose kimike, ose studion dhe diagnostikon sëmundjet.



Kryeni kërkime mjekësore, diagnostikoni dhe/ose trajtoni sëmundjet, terapinë ose kujdesin që lidhet me shëndetin, mbajtjen e rezultateve.



Të rrisë të mbjellat, bagëtinë, të instalojë dhe të mirëmbajë peizazhin, të studiojë dhe të mbrojë mjedisin.

Shënim: Profesionet/Interesat e përgjithshme nuk janë njësoj si aftësitë. Ato reflektojnë motivimin tuaj drejt një fushe karriere, por jo aftësinë për të punuar në këtë fushë. Shumica e njerëzve kanë aftësi që mbështetin interesat e tyre. Nëse jo, ata zakonisht përpiqen të zhvillojnë më tej aftësitë e tyre apo të shikojnë për një fushë të dytë për karrierë. Për shembull, dikush që pëlqen sportin por nuk ka aftësitë për të bërë karrierë në sport, mund të vendosë të bëhet një trajner ose arbitër.

Fusha e Aftësive, kriter kyç për zgjedhjen e profesionit

Fusha e Aftësive, kriter kyç për zgjedhjen e profesionit


Meggan, të kuptuarit e aftësive tuaja, do të jetë i rëndësishëm ndërsa vlerësoni fushat e karrierës dhe profesionet. Është shumë e rëndësishme që të lidhni punën tuaj me aftësitë tuaja më të mira, që të përfitoni gëzimin personal e të bërit diçka që ju vjen natyrshëm.

Ka dy arsye kryesore për të ndërtuar pikat tuaja të forta. Së pari, do t'ju ndihmojë për të maksimizuar potencialin tuaj. Të punoni me pikat tuaja të forta të lindura, ju ndihmon të mësoni më shpejt, dhe të arrini më shumë, me të njëjtin nivel përpjekjesh. Për shembull, disa njerëz mund të praktikojnë të kënduarit për vite me radhë, por kurrë nuk kanë aftësinë për të qenë të suksesshëm si një këngëtar, duke qenë se nuk kanë aftësi të lindura për të shkëlqyer.

Së dyti, të punosh me pikat e forta të lindura është më tepër kënaqësi. Është e vërtetë që njerëzit përjetojnë më pak stres në punë kur përdorin aftësitë me të cilat ata ndihen rehat. Është gjithashtu logjike që të kënaqeni kur përdorni këto aftësi duke qenë se janë njohur, vlerësuar, dhe shpërblyer nga të tjerët në të kaluarën. Besimi juaj do të vazhdojë të rritet ndërsa përdorni aftësitë e lindura, të cilat ju çojnë edhe në më tepër sukses dhe gëzim në të ardhmen.


Ajo që është më e rëndësishme është se ju shkëlqeni kur përdorni aftësitë që vijnë natyrshëm dhe sjellin gëzim kur i përdorni. Gjithsesi, duhet të jeni të vetëdijshëm për dobësitë tuaja, por nuk duhet të jenë në fokusin e punës tuaj. Në fushën e aftësive, përpiquni të ecni përkrah saj dhe jo kundër saj.

Aftësitë dhe mundësitë




Shënim: Pikët e aftësisë tek ky seksion janë nga vetëvlerësimi, dhe jo nga një test i arritjeve apo përvojave tuaja. Studimi tregon se vetëvlerësimi mund të japë një vështrim të saktë për aftësitë e një personi.

3.1 Aftësitë dhe mundësitë: Katër Fushat e Para




Nëse shkëlqen në udhëheqje, ka të ngjarë të kesh një ndjenjë të lartë iniciative të nxitur nga interesimi për të tjerët ose nga lidhja me të tjerët. Mund të jesh vizionar ose idealist dhe i gatshëm për të ushtruar ndikimin tënd mbi të tjerët. Mund të jesh në krye të një grupi ose të udhëheqësh edhe si anëtar grupi dhe të punosh përkrah individëve që shërben. Sido që të jetë, je i respektuar për integritetin dhe besueshmërinë tënde. Ndiq mundësitë që të japin forcë për të mësuar dhe për të dhënë mësim si përbërës i ndërtimit të marrëdhënieve.



Ti ke dashuri për gjuhën, si edhe një dëshirë të zjarrtë për t'u angazhuar me njerëz të kulturave të ndryshme. Ke një aftësi për të perceptuar, kuptuar dhe u përshtatur me zakonet e kulturave të tjera. Ndoshta mezi pret të udhëtosh që të përjetosh kultura dhe tradita të tjera. Zakonisht, do të jetë më e përshtatshme në qoftë se eksploron interesat e tua në një dimension të përkthimit të gjuhëve ose ndërmjetësimin e dallimeve kulturore, qoftë në një biznes, qeveri, shërbime sociale ose përpjekjet humanitare.



Ka të ngjarë që të shkëlqesh kur koordinon aktivitetet e të tjerëve. I delegon detyrat, i motivon të tjerët që të punojnë në bashkëpunim dhe i përmbush me sukses afatet kohore, sepse njerëzit i përgjigjen menjëherë drejtimit tuaj. Je i aftë në menaxhimin e projekteve dhe mund të parashikosh, pastaj lundrosh në çdo fazë të punës së nevojshme për të përfunduar një detyrë komplekse. E përballon një shkallë të lartë urgjence me aftësinë tuaj për të qenë fleksibël dhe për të bërë rregullime në këtë moment. Duke vlerësuar me shpejtësi opsionet e situatës, përshtatesh me mjedise me ritëm të shpejtë dhe në ndryshim. Për të maksimizuar përdorimin e këtyre aftësive, duhet të konsiderosh profesione që përfshijnë nisjen e një biznesi, mbikëqyrjen e të tjerëve dhe/ose mbikëqyrjen e operacioneve.



Ti percepton në mënyrë të natyrshme natyrisht se si procedurat e detajuara dhe materialet duhet të mbahen saktë dhe në mënyrë të mirë për të maksimizuar efikasitetin. Je metodik/e, i/e rregullt dhe sistematik/e në qasjen tuaj ndaj një detyre dhe zakonisht shkëlqen në detyrat administrative që përfshijnë dhënien dhe marrjen e informacionit dhe furnizimeve në mënyrë të rregullt për të drejtuar operacionet e përditshme të një zyre ose biznesi të drejtuar nga klientët. Planifikimi dhe orari, si edhe kryerja e detyrave të zakonshme, aftësitë të shkëlqyera motorike dhe kontrolli i cilësisë, janë aktivitete që i bëni pa problem ndërsa bëni shumë gjëra. Maksimizoj pikat e forta duke ndjekur profesione që përfshijnë menaxhimin e saktë të të dhënave/ inventarit, matematikën e shpejtë bazë, komunikimin e qartë, mbështetjen administrative ose shërbimin ndaj klientit dhe aftësinë në përdorimin e pajisjeve të zyrës ose mjeteve të specializuara.

3.2 Aftësitë dhe mundësitë: Vlerësoni Aftësitë Tuaja

Shqyrtoni me kujdes aftësitë tuaja të renditura në krye të klasifikimit dhe analizoni lidhjen midis tyre. Sa mbivendosje ekzistojnë? A lidhet ndonjë prej aftësive tuaja me fusha që ju i shihni më shumë si hobi se sa si një bazë për profesionin tuaj? Në qoftë se po, a ekzistojnë mënyra që këto aftësi për hobi mund të transferohen në punën tuaj? Plani i veprimit që do t'i bashkëngjitet raportit tuaj, do t'ju drejtojë drejt zgjidhjes së këtyre dilemave apo pyetjeve të tjera. Përfundimi i kësaj analize do të jetë çelësi i përfitimit të plotë nga ky raport.


ZHVILLONI AFTËSITË TUAJA

Shfrytëzimi i pikave të forta personale të lindura, nuk do të thotë që nuk kërkohen trajnime, shkollimi, puna e vazhdueshme dhe perkushtimi për të zhvilluar më tej aftësitë tuaja. Në të kundërt, shumë njerëz të suksesshëm bëhen të tillë duke punuar në mënyrë të zellshme në punën e tyre. Mendoni për lojtarët profesionistë të futbollit të cilët zhvillojnë aftësitë e tyre sportive duke gjuajtur me dhjetëra topa në ditë. Gjithashtu, mendoni një pianist i cili shpenzon orë të tëra, duke u praktikuar në mënyrë që të zhvillojë plotësisht aftësitë e lindura muzikore.

MINIMIZONI EKSPOZIMIN E AFTËSIVE TUAJA MË TË ULËTA

Meggan, ashtu si edhe me interesat tuaja, ju lutem mbani shënim fushat e aftësive në të cilat dolët dobët. Ato janë te renditura në fund të grafikut në faqen tjetër. Fushat me rezultate të ulëta mund të shfaqin disa pamje rreth interesit të karrierës. Mbase nuk janë pika të forta të lindura, ose mbase nuk keni patur kurrë mundësinë t'i zhvilloni ato. Sidoqoftë, do të jetë më mirë të mos ndiqni profesione që kërkojnë përdorim të madh të aftësive tuaja më pak të larta, vetëm në qoftë se ndiqni më përpara seminare trajnimi.

KATËR FUSHAT E AFTËSIVE MË TË ULËTA



Vlerat janë të rëndësishme për vendimet në karrierë

Vlerat janë të rëndësishme për vendimet në karrierë

Meggan, ju mund të pozicionoheni në një fushë karriere që përputhet më së miri me interesat profesionale, aftësitë dhe fuqitë e personalitetit dhe të ndiheni përsëri i pakënaqur në punë dhe të stresoheni në qoftë se puna juaj nuk përputhet me vlerat tuaja. Për shembull, shumë njerëz vlerësojnë të punuarit në natyrë dhe asnjëherë nuk do të ndihen plotësisht rehat duke punuar brenda mureve të një ndërtese. Të tjerë duan të dinë që po ndihmojnë në mënyrë direkte njerëzit nëpërmjet punës së tyre dhe nuk do të kënaqeshin të punonin vetëm apo me makineri.

Shumë njerëz mendojnë se nëse një punë i bën ata të suksesshëm në kuptimin material, atëherë ata mund të jenë të lumtur duke bërë çfarëdo lloj pune. Shumë shpesh, ata e gjejnë veten të paplotësuar dhe të rraskapitur, vetëm pas pak vitesh në karrierën e tyre. Duke përdorur vlerat si një kriter për zgjedhjet e karrierës, mund të përjashtohet një pjesë e madhe e zhgënjimit dhe stresit që është i pranishëm në vendin e punës. Ndërsa shqyrtoni prioritetet tuaja, për të parë nëse jeni të qëndrueshëm, krahasojini ato me mënyrën si po vepronin vërtet. Kjo pjesë me tre nënpjesë mbi vlerat, është hartuar për t'ju ndihmojë të përcaktoni prioritetet dhe vlerat që do t'ju udhëheqin si në jetë dhe në punë.


Prisni që vlerat tuaja të ndryshojnë; këto janë prioritete dhe ju mund t'i ndryshoni sa herë që do të dëshironit. Shumica e njerëzve e kuptojnë se ata i ndryshojnë disa nga prioritetet ndërsa rriten apo me ndryshimin e situatave të tyre familjare. Është ide e mirë të ruhet ky raport si një referencë për të ardhmen. Një rishikim i herë pas hershëm, do t'ju japë mundësi të bëni një rifreskim dhe të shikoni përputhjen me prioritetet tuaja.

4.1 Vlerat: Mjedisi i Punës

Njerëz të ndryshëm preferojnë ose madje kërkojnë lloje të ndryshme mjedisesh në vendin e tyre të punës, në mënyrë që të funksionojnë në maksimum. Ato lloj kushtesh që duan kur shkojnë në punë, si për shembull në ambientin e tyre fizik, në orarin e punës ose në atmosferën e punës, të gjitha kontribuojnë në mjedisin e tyre të punës. Për shembull, disa njerëz mund të lulëzojnë vetëm kur mjedisi i tyre është shumë i organizuar, kurse të tjerë mund të mos shqetësohen nga ndonjë shkallë çorganizimi.

Është e rëndësishme që të jesh në gjendje të identifikosh llojin e mjedisit që dëshiron, ose edhe që ke nevojë, për të funksionuar sipas mundësive të tua më të mëdha. Të kuptuarit e kësaj mund të të ndihmojë ndërsa vlerësoni mundësitë e ndryshme të karrierës që vijnë në rrugën tuaj.

PRIORITETET TUAJA PËR 12 ELEMENTËT QË KANË TË BËJNË MË MJEDISIN E PUNËS



KONSIDERONI 4 TË PARAT SI KRITERE TË RËNDËSISHME PËR TË VLERËSUAR POZICIONET DHE PROFESIONET E MUNDSHME

1. Pavarësi

Ju dëshironi të merrni vendime për veten tuaj, kështu që kërkon për autonomi të konsiderueshme në punën tuaj. është shumë e rëndësishme t'i bëni gjërat në mënyrën që do donit t'i bënit. çdonjeri duhet të ketë disa udhëzime, por është e rëndësishme që ju të jeni në gjendje të eksperimentoni me idetë tuaja dhe të punonit pa patur dikë mbi kokë.

2. Aventurë/ ngjarje me rrezik

Ju pëlqeni të jeni në vende ku ka shumë intensitet veprimi, edhe kur kjo është disi e rrezikshme. Përjetimi i aventurave dhe të punuarit me të panjohurën dhe të paparashikueshmen ju mban të motivuar në punën tuaj.

3. Udhëtime

Kërkoni profesione të cilat ju krijojnë mundësi të udhëtoni dhe shikoni pjesë të ndryshme të botës. Ju kënaqeni kur takoni njerëz të rinj, ndërromni udhëtime të shpeshta, dhe keni përgjegjësi jashtë zyrës.

4. Sfidues


Keni nevojë për mundësi në cilat mund të zgjidhni probleme të vështira dhe të punoni në çështje pune të tilla si "ta bëjmë ose ta lëmë fare". Kërkoni për detyra të vështira dhe pengesa për t'i kapërcyer. Polemika nuk është një problem për ju, sepse juve ju pëlqen të vendosni rregull në një situatë kaotike.

4.2 Vlerat: Rezultatet e Punës

Megjithëse shumica e njerëzve presin një numër shpërblimesh nga puna e tyre, është e rëndësishme që ju të vendosni se çfarë është më e rëndësishme. Për shembull, më shumë shkollim dhe të ardhura më të larta zakonisht shkojnë së bashku, por përtej një niveli të caktuar, shkollimi i vazhdueshëm nuk mund të lidhet me të ardhura më të larta. Gjithashtu, të qenit në një pozicion drejtues, jo patjetër jep siguri. Edhe pse e mendojmë apo jo këtë gjë, shumica prej nesh duhet të bëjnë zgjedhje të vështira në këtë fushë.

Është shumë e rëndësishme që të kuptoni se prioritetet tuaja janë një çështje individuale. Të lejosh dikë tjetër që të ushtrojë ndikim mbi vlerat e punës, është një nga gabimet më të mëdha që bëjnë njerëzit kur zgjedhin një fushë të caktuar karriere. Ju takon ju të mendoni për këtë fushë kritike dhe të siguroheni që e keni kuptuar çfarë është me të vërtetë e rëndësishme për ju.

KËTU JANË PRIORITETET TUAJA PËR 8 REZULTATET QË PRISNI NGA PUNA



KËTO REZULTATE JANË MË TË RËNDËSISHMET PËR JU

1. Njohja (vlerësim/famë)

Keni vullnet të punoni shumë për t'u njohur si dikush që lë gjurmë në lidhje me diçka. Njohja e arritjeve tuaj është një motivim madhor për ju, kështu që analizoni me kujdes zgjedhjet tuaja për profesionin, për të qenë të sigurt se ka një sistem shpërblimi të përcaktuar.

2. Udhëheqje

Ndiheni rehat në pozicione në të cilat keni përgjegjësi për njerëzit dhe burimet. Jeni rehat kur merrni në kontroll një situat, duke u treguar të tjerëve se çfarë duhet të bëjnë, dhe kur merrni vendime për grupin. Puna juaj duhet të përfshijë mundësi për të drejtuar një grup drejt qëllimeve të përbashkëta.

3. Të ndihmoj të tjerët

Është shumë e rëndësishme që të kontribuoni në mirëqënien apo rritjen e të tjerëve dhe kjo duhet të jetë pjesë integrale e punës suaj. Kjo mund të arrihet nëpërmjet trajnimit, mësimdhënies, këshillimit, inkurajimit, dhe sigurimit të burimeve financiare. Zgjedhja juaj profesionale duhet t'ju ofrojë mundësinë e shprehjes së kujdesit për të tjerët.

4. Stimulim intelektual


Kënaqeni kur mendoni për çështje komplekse dhe aplikoni aftësi të arsyeshme për të zgjidhur problemet. Mundësia për të kërkuar informacion shtesë dhe të menduarit në nivel intelektual duhet të jetë pjesë e kriterit tuaj për përcaktimin e profesionit.

4.3 Vlerat: Vlerat e Jetës

Kjo fushë është e rëndësishme për planifikimin e karrierës sepse shumë njerëz e kanë të vështirë të rakordojnë mënyrën si jetojnë dhe punojnë, me vlerat e tyre të jetës. Ritmi i shpejtë i jetës, tensionet e detyrimeve financiare, dhe kompleksiteti i jetës në këtë kohë, bën që shumë njerëz të ndihen sikur e vetmja gjë që dinë të bëjnë, është të shtyjnë edhe një ditë.

Gjithsesi, përvoja tregon se njerëzit që vendosin në mënyrë të kujdesshme mbi qëllimin e jetës dhe më pas bëjnë zgjedhjet e karrierës që kontribuojnë për këtë qëllim, kanë një qetësi të veçantë dhe një ndjenjë të përmbushjes në punën e tyre. Katër çështjet kryesore që kanë të bëjnë me qëllimin e jetës janë renditur në faqen tjetër.

JU KENI PËRZGJEDHUR 9 ÇËSHTJE QË KANË TË BËJNË ME QËLLIMIN E JETËS



POSHTË JANË RENDITUR 4 PRIORITETET KRYESORE

1. Arritjet

I vini vetes qëllime të larta dhe përpiqeni për përsosmëri në gjithçka që bëni. Arritja e potencialit tuaj të plotë në punë është shumë e rëndësishme për ju. Shikoni për mundësitë e karrierës në të cilin jeni në gjendje të vendosni qëllime të larta dhe të shihni rezultatet e përpjekjeve tuaja.

2. Besimi

Ju keni pranuar se misioni i jetës suaj përfshin shërbimin ndaj Zotit në cdo gjë që bëni. Do të ishte shumë e rëndësishme për ju të shikoni se si puna juaj mund të kontribuojë drejt këtij qëllimi. Mos harro se cdo profesion është një mundësi për t'i shërbyer Atij. Mirësia dhe një përkushtim ndaj të qënurit i shkëlqyer mund të jenë shumë tërheqëse për të tjerët në vendin e punës.

3. Familja

Familja për ju ka një vlerë të madhe dhe doni të jeni në gjendje të kujdeseni për ta sa herë që ata kanë nevojë. E shikoni tepër të rëndësishme të jeni i vlefshëm dhe të përfshiheni në aktivitetet e tyre. Të paturit e një kohe cilësore me familjen tuaj është e rëndësishme për ju dhe duhet marrë në konsideratë në zgjedhjen që bëni në lidhje me profesionin.

4. Estetika

Shprehja artistike dhe krijueshmëria janë prioritete madhore në jetën tuaj. Kënaqeni kur përfshiheni në aktivitete që e bëjnë jetën më të bukur, në të cilat mund të përdorni ndjeshmërinë emocionale, dhe mund të shprehni në mënyrë të lirshme pikëpamjet dhe talentet tuaja krijuese.

GJENI EKUILIBRIN E DUHUR NË VLERAT TUAJA

Asnjë njeri nuk është i përsosur, Supermeni dhe Gruaja Perfekte nuk ekzistojnë, dhe kurrë nuk do të jeni në gjendje të bëni gjërat në nivelin që do të dëshironit. Gjithsecili duhet të ketë një ekuilibër në jetën e vet. Duke pasur parasysh prioritetet tuaja, do të jeni në gjendje të gjeni një ekuilibër të përshtatshëm në përdorimin e kohës, energjive dhe burimeve financiare. Lista juaj e prioriteteve do t'ju ndihmojë të përmbushni vlerat e qëllimit tuaj në jetë.

PRISNI QË VLERAT TUAJA TË NDRYSHOJNË

Këto janë prioritetet tuaja dhe ju mund t'i ndryshoni sa herë që të dëshironi. Shumica e njerëzve e kuptojnë se ata i ndryshojnë disa nga prioritetet ndërsa rriten apo kur ndryshon situata e tyre familjare. Është një ide e mirë të ruhet ky raport si një referencë për të ardhmen. Një rishikim i herë pas hershëm, do t'ju japë mundësi të bëni një rifreskim dhe të shikoni sa mirë po i mbani prioritetet tuaja.

ÇFARË TË BËJ TANI?

Krahasoni fazat e zhvillimit të karrierës suaj me një udhëtim familjar nëpër Shqipëri. Ka dy faza të dukshme; Faza e parë ka të bëjë me kryerjen e kërkimit dhe planifikimit për t'i bërë pushimet sa më të këndshme. Faza e dytë ka të bëjë me hipjen në makinë, pozicionimit në rrugë, dhe nisjen e udhëtimit.


Leximi i raportit të CAREER DIRECT është si të studioni një hartë rrugore gjatë fazës së parë të planifikimit të udhëtimit. Ai ju ofron një pamje të gjerë të drejtimeve të përgjithshme për të arritur në destinacionin tuaj së bashku me disa rrugë alternative për të arritur atje. Sidoqoftë, vetëm leximi i raportit nuk do të zgjidhë dilemat e karrierës tuaj, ashtu sikurse thjesht leximi i hartës së rrugës nuk ju çon në vend-mbërritjen e dëshiruar të pushimeve.

Tani ju e gjeni veten në fazën e dytë. Është koha që të uleni në sediljen e shoferit dhe të filloni udhëtimin e karrierës tuaj. Hapi juaj i parë është të ktheni informacionin në plane dhe vendime, që do të përcaktojnë nisjen e udhëtimit. Për t'ju ndihmuar në këtë hap kyç, ne kemi përgatitur Planin e veprimit, një udhëzues për të interpretuar ato që keni mësuar rreth modelit tuaj të punës dhe vepruar mbi to. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që ju ta zbatoni atë plotësisht. Unë do t'ju ndihmoj të përputhni modelin tuaj me profesione të ndryshme dhe programe arsimore trajnimi.


Mbi të gjitha, mos harroni se qëllimi kryesor në planifikimin e karrierës është përputhja e talenteve dhe interesave, me kërkesat e punës tuaj. Vetëm duke vepruar kështu, do të keni shanse më të mëdha për të arritur në destinacionin tuaj, një karrierë që ju përshtatet plotësisht.

Tabela përmbledhëse e personalitetit

1.1 Gjashtë Faktorët e Personalitetit



1.2 PIKAT TUAJA KRYESORE TË PERSONALITETIT



1.3 PËRMBLEDHJA E PERSONALITETIT

Aventurier - Aventurier, ambicioz, konkurrues dhe i tërhequr prej sfidave.

I dhembshur - I mëshirshëm, i ndjeshëm, dhe një dëgjues i mirë; i durueshëm, besnik, mbështetës dhe inkurajues ndaj të tjerëve.


KRIJUESHMËRISË - Tepër krijues. Ju pëlqen në veçanti të shprehni ide të reja dhe të kërkonit sfida mendore.

Ekstrovert - Shumë shoqëror, i orientuar rreth njerëzve, kënaqeni duke takuar njerëz të rinj; entuziast dhe i mirë për të lidhur njerëzit bashkë (networking).


Dominues - Guximtar, vetëmbështetës, i pavarur, i orientuar drejt rezultateve dhe në mënyrë të natyrshme dëshironi të merrni rolin e udhëheqësit.

I pastrukturuar / I ndërgjegjshëm (Mesatare) - I strukturuar në disa fusha dhe veproni spontanisht me të tjerët.


1.4 Çështjet Kritike të Jetës




2.1 Interesat e Përgjithshme




2.2 8 Grupet Kryesorë të Karrierës




3.1 Aftësitë dhe mundësitë



4 Prioritetet Integruese të Vlerave



Vlerat Themelore të Jetës që lidhen me planifikimin



Pjesa 5: Career Direct – Hapat Vijues

Career Direct – Hapat Vijues

Urime në plotësimin e mjetit Career Direct dhe punës përmes Raportit tuaj të detajuar!

Ja disa parime themelore për t'u kuptuar. Para se të vazhdoni me Hapat Vijues, ju lutemi të studjoni secilën me kujdes dhe t'i diskutoni me dikë që i besoni.

- Ju keni një dizajn unik, i cili nuk mund të injorohet. Përqafimi i dizajnit tuaj është kritik në zbulimin e misionit tuaj në jetë. Injorimi i thurjes suaj unike mund të shkaktojë frustrim të madh, vendimarrje të dobët dhe përfundimisht marrëdhënie të shkatërruara.
- Puna juaj është një udhëtim marrëdhëniesh i pazbuluar, jo thjesht një seri ngjarjesh tranzite. Ji i ndjeshëm dhe i hapur për të pranuar këshillë dhe drejtim në kërkimin tuaj dhe marrjen e vendimit.
- Lidhja e dizajnit tuaj me karrierën është një përgjegjësi që zgjat gjithë jetën. Ndërsa jeta ndryshon, vjen një kohë kur mund të ndihesh i/e shkëputur prej marrëdhëniesh, punës dhe jetës. Kjo zakonisht tregon se ka ardhur koha të rivlerësoni dhe përsërisni procesin e Career Direct.
- Suksesi në udhëtimin tuaj do të kërkojë shumë punë, besnikëri dhe këmbëngulje. Studimi i raportit tuaj, kërkimi për zgjedhje të mundshme të karrierës janë hapa të domosdoshëm, si edhe vullnetarizmi në një fushë që përshtatet me dizajnin tuaj mund të jenë me përfitim.
- Je në prag të marrjes së një vendimi kritik për karrierën. Një themel i fortë është kritik në shmangien e shkatërrimit. I vetmi themel për një vendim të mencur për karrierën është:
 - Sigurohu që vendimi juaj përputhet me mënyrën si je krijuar.
 - Merr një vendim të mencur mbi vlera të përhershme dhe themelore të jetës!
 - Shmang të gjitha themelet jo të vërteta PAVARESIHT KOSTOS!
 - Pranimi i vendit të punës më të lehtë që të ofrohet në fillim
 - Paraja si motivimi parësor
 - Titulli i punës apo prestigji
 - Siguria, pushteti dhe kontrolli
 - Të ndjekësh atë që të thonë shokët
 - Të kërkoësh kategorinë e punëve "më të kërkuara"
 - Të ndjekësh hapat e prindërve dhe të përmbushësh ëndrrat e tyre
 - Të pranosh një vend pune vetëm sepse mund ta bësh atë punë

Tani që ke një kuptim të qëndrueshëm të parimeve themeltare të një vendimarrje të zgjuar për karrierën, le të vazhdojmë me Hapat Vijues:

Hapi 1:

- Nëse nuk keni një Këshilltar të Career Direct, shëno gjetjen e një trajneri apo mentori që do të ju ndihmojë për të rishikuar vlerësimin, si edhe të ju gjendet pranë rregullisht në lidhje me të ardhmen tuaj. Nëse keni dëshirë, [mund të lidheni që tani me një Këshilltar të Career Direct!](#)

Hapi 2:

- Rishiko vlerësimin tuaj në *Raportin e detajuar Career Direct®* PERSERI.
- Vini re informacionin në raportin tuaj që [mund të mos](#) gjejë zbatim për ju. Nëse nuk bini dakort me një gjë, pyesni konsulentin apo trajnerin tuaj për të konfirmuar mendimet tuaja. Kur të jenë konfirmuar, nënvizoni ato gjëra që nuk gjejnë zbatim për ju
- Shënoni me ngjyrë apo nënvizoni pikat kyce që ju apo konsulenti juaj u fokusuar ne raport.
- Mbaj shënim rekomandimet kryesore për karrierën që konsulenti ju dha. Nëse nuk patët një konsulent të Career Direct, atëherë nuk keni këto rekomandime.

Hapi 3:

- Klikoni në linkun e karrierës së dëshiruar apo rekomanduar në listën tuaj me 8 Grupet e Interesave, dhe vazhdoni kërkimin për të ju ndihmuar të përputhni fushat e mundshme të karrierës me Personalitetin, Interesat, Aftësitë, Vlerat tuaja
- Cdo karrierë kërkon një konfigurim specifik të Personalitetit, Interesave, Aftësive dhe Vlerave, në mënyrë që të rezultojë e suksesshme. Mos harroni se karriera që do të zgjidhni duhet të përputhet me të Katër dimensionet e dizajnit tuaj. Do të gjeni informacionin e nevojshëm rreth personalitetit, interesave, aftësive dhe vlerave duke klikuar tek linqet e Punëve të Detajuara më poshtë
- Këshillohu me [Listën e Profesioneve \(Shkarkoje KETU\)](#) për një listë më të plotë të karrierës në fushat tuaja specifike të interesit

8 Grupet Kryesore të Interesave Linqet e detajeve të punëve

1. Marrëdhëniet ndër-kulturore

Agjent i Shërbimit të Huaj	Mësues i Gjuhës së Huaj	Përkthyes tekstesh, librash/Përkthyes simultant
Stjuardesë	Diplomat/Ambasador	Guidë turistike/Agjent Udhëtimi
Ekzekutiv Ndërkombëtar i Biznesit	Oficer i Kombeve të Bashkuara	Gazetar/Korrespondent i huaj jashtë vendit

2. Art/Dizajn

Dizajner Grafik	Dizajner i Përbajtjes Dixhitale	Arkitekt Peisazhi
Stilist	Arredues i Brendshëm	Artist
Skulptor/Argjendar	Skenograf teatri	Fotograf

3. Ligji/politika

Avokat	Analist ligjor	Analist i Analizave Politike
Arbitër/Ndërmjetës/Pajtuës	Legjislator (Shtetëror, Rajonal)	Gjykatës
Deputet/Qeveritar	Specialist i Çështjeve Politike	Paralegal/Ndihmës Ligjor/Nëpunës i Ligjit

4. Besimi, shërbimi/misionet

Mësues i fesë	Udhëheqësi i adhurimit	Ministër/Drejtor i Fëmijëve
Pastori/drejtori i të rinjve	Misionar (e huaj ose vendase)	Ungjilltar
Klerikë (Misionar, Prift, Pastor, Rabin)	Kapelan (Ushtarak, Korporate, Burg, Spital)	Përkthyes/Komentator/Botues i Tekstit Fetar

5. Arsimi

Instruktur i tregtisë	Trajner i korporatës	Drejtor i shkollës
Administrator i Arsimit të Lartë	Profesor	Specialist i Arsimit
Mësues asistent/Ndihmës mësues në klasë	Hartues i Kurrikulës Dixhitale (online ose në klasë)	Pedagog/Mësues privat

6. Shërbimi/Administrata

Nëpunës banke	Bashkëpunëtor i shitjeve me pakicë	Asistent Administrativ
Asistent Ekzekutiv	Analist i shërbimit teknik	Koordinator programi ose projekti
Menaxhues Zyresh	Avokat i Organizatave bamirëse jofitimprurëse/jo-qeveritare (OJQ)	Receptionist tek sporteli (përsëndetja dhe orientimi i mysafirëve/klientëve, caktimi i takimeve, u përgjigjesh telefonave)

7. Performanca/Komunikimi

Këngëtar/Valltar/Model	Moderator në Radio/TV /Podcast	Producent/Regjisor
Muzikant/Dirigjent muzike	Teknikë audio/video	Aktor/Aktore/Komedian
Kameraman në Televizion, për Video/Filma	Analistë të lajmeve, Gazetarët/Reporterët	Autor/Shkrimtar (libër, blog, përmbajtje web, media sociale)

8. Llogaritëse/Financiare

Programues Programesh Kompjuterikë

Bankier/Oficer kredie

Analist financiar/i investimeve

Ekonomist

Statisticien

Planifikues/Këshillues Financiar

Llogaritar

Analist i të dhënave

Inspektor/Llogaritar

Hapi 4:

- Plotësoni [Planin e Veprimit](#) duke përdorur informacionin kyc në Raportin e Detajuar dhe kërkimet tuaja. Ky hap është kritik për të plotësuar hapat e tjerë!
- Ki parasysh pyetjet e mëposhtme ndërsa plotëson Planin e Veprimit
 - Cilat janë pikat e tua të forta unike dhe motivimi që do të të ndihmojë të shkëlqesh në vendin e punës?
 - Cili është modeli i karakteristikave tuaja të lindura që lidhen me punën?
 - Cilat janë fushat e karrierës dhe profesionet specifike për të cilat ke më shumë interes?
 - Sipas kërkimit tuaj, cilat janë kërkesat dhe karakteristikat e vecanta, që kërkohen për keto profesione?
 - Cilat fusha karriere dhe profesione përputhen më mirë me dizajnin tuaj unik?
 - Cfarë do të bëni për të ndjekur mundësitë e atyre profesioneve që ju përshtaten më mirë ?
 - Të hedhësh dritë mbi profesionin?
 - Të ndihmohesh si vullnetar?
 - Të bëhesh një praktikant?
 - Të flasësh me njerëzit e atij profesioni?

Hapi 5:

- Nëse gjen aplikim: Lutuni gjithmonë përgjatë gjithë procesit të vendimarrjes ndërkohë që kërkoni këshilla të perëndishme dhe flisni me njerëzit e fushave që përputhen më shumë me personalitetin tuaj dhe menyrën si jeni krijuar. Kërkoni mundësi punësimi në fushat e interesit.

Burimet

Ky seksion siguron burime ndihmë dhe linqe të burimeve dhe shërbimeve që do të ju ndihmojnë gjatë rrugës së përmbushjes së karrierës.

- [Udhërrëfyes elektronik për Degët e Studimit Universitar dhe Zgjedhjet e Karrierës.](#)

Libri referues *i Udhërrëfyesi për Degët e Studimit Universitar dhe Zgjedhjet e Karrierës* siguron këshilla praktike për zbulimin e degëve të mundshme të studimit, dhe *zgjedhjen e një dege studimi universitar apo profesional* dokumenti në burimin online ndihmon për të përputhur interesat e tua me një degë studimi universitar apo formimi profesional

- [Zgjedhja e Degës së Studimit Universitar apo Formimit Profesional](#)

Ky dokument përfshin procesin e ndërlidhjes së fushave të karrierës dhe profesioneve më kryesore për ty me degën e studimit universitar apo formimit profesional.

- [Model i Profesioneve](#)

Modeli i Profesioneve

është dizenuar për të ju ndihmuar të zgjeroni vizionin rreth mundësive të punësimit bazuar mbi fushat tuaja të interesit rreth punësimit. 9 profesionet për secilënë të interesit janë dhënë vetëm si shembuj. Ky *Model Profesionesh* përmban një listë të plotë të profesioneve të cilat mund të shqyrtohen më tej përmes O*Net dhe Librit të Vështrimit mbi Profesionet, në linqet e mëposhtme.

- [O*Net Online](#)

O*Net Online është një databazë me informacion të detajuar për profesione specifike nga Buletini i Statistikave të Punës. Ky burim online përmban informacion rreth të gjithave profesioneve të përmendura në *Modelin e Profesioneve*

duke përfshirë aftësitë e kërkuara, njohuritë dhe arsimimin e nevojshëm, përgjegjësitë e punës, aktivitetet e lidhura me të, nivelin e kompetencës, pagën mesatare, dhe shumë më tepër.

- [Libri i Vështrimit mbi Profesionet](#)

Databaza e Librit të Vështrimit mbi Profesionet, mirëmbahet gjithashtu nga Buletini i Statistikave të Punës dhe jep përshkrime të detajuara të 260 profesioneve që përfaqsojnë rreth 90% të të gjitha profesioneve të zgjedhura nga amerikanët.

- [Crown Financial Ministries](#)

Crown Financial Ministries është organizata mëmë që zhvilloi Sistemin e Plotë Udhëzues të Career Direct®. Është një shërbesë ndërkombëtare, jo denominacionale, e cila siguron materiale për kishat dhe individët, seminare, 4 programe kombëtare radiofonike, një web faqe online e vlerësuar me cmim, Money Map Coaching/ Harta e Trajnimit mbi Paratë, dhe burime mbi karrierën të cilat na mësojnë rreth lirisë së vërtetë financiare. Na vizitoni online për më shumë informacion rreth kësaj shërbese dinamike.

- [Dyqani i Burimeve të Crown Financial Ministries](#)

Klikoni këtu për të parë gjithë produktet dhe shërbimet e mundësuar nga Crown Financial Ministries.

- [Shërbimi i Rezymeve Pongo™](#)

*Në tregun e sotëm konkurrues të punës, një rezyme e shkruar mirë është faktori më i rëndësishëm për të ju ndihmuar të shkëlqoni në derën dhe të stabilizoheni në pozicionin e përsosur. **NDERTUESI** dhe **PUBLIKUESI** i Rezymeve ju jep një mjet për të krijuar, printuar, dërguar në mënyrë elektronike, apo me faks, rezymenë tuaj shpejt dhe lehtësisht, të gjitha nga një vend i përshtatshëm-online! (Ju lutem vini re se ky link i përket një pale të tretë)*

- [Iventari Personal i Karrierës](#)

Ky pyetësor do t'ju ndihmojë të klasifikoni disa nga çështjet e rëndësishme të karrierës përpara se të plotësoni hapat e mëposhtëm. Mund ta shkruash dhe printosh informacionin tuaj në PDF, por nuk do ta ruajë informacionin tuaj.

- [Iventari Personal i Planifikimit të Arsimimit dhe Karrierës](#)

Plotësimi i këtij pyetësori të shkurtër nga kompjuteri juaj, do të ju ndihmojë të adresoni çështjet më të rëndësishme të karrierës.

Audio Files:

Mesazhi Audio #1 – "Parimet e Përbushjes së Karrierës" (28 minuta)

Ky mesazh përmban inkurajim dhe këshilla të urta për të qenë me të vërtetë i suksesshëm në karrierën dhe jetën tuaj.

- Sesioni Një:**
- Perëndia është origjina e vërtetë e punës
 - Të gjitha punët kanë kuptim dhe dinjitet
- Sesioni Dy:**
- Thirrja juaj – Plani i Perëndisë për jetën tuaj
 - Puna është një platformë për shërbesë dhe dëshmim.
- Sesioni Tre:**
- Shkëlqyeshmëri në vendin e punës
 - Perëndia është autoriteti ynë final

Mesazhi audio #2 – "Si të përfitosh rezultatet më të mira nga testi Career Direct®" (36 minuta)

Ky mesazh jep udhëzime specifike për të përfituar në mënyrë maksimale nga test vlerësimi Career Direct®.

- Sesioni Një:**
- Ndryshimet në Vendin e Punës në Gjeneratën e Sotme
- Sesioni Dy:**
- 10 Tendencat në Ambientin e Sotëm të Punës
- Sesioni Tre:**
- Përputhja e Modelit tuaj me Profesionet Përkatëse
- Sesioni Katër:**
- Përfitimet e Perspektivës Biblike mbi Zgjedhjen e Karrierës

Mesazhi Audio #3 – "Të kuptuarit e Dizenjosh së dhënë nga Perëndia/ Interpretimi i Raportit tuaj nga Career Direct" (55 minuta)

Ky mesazh jep themelet e bazave të dizenjimit tonë unik nga Perëndia. Ai na ka dhënë talente dhe aftësi të vecanta që të arrijmë potencialin tonë. Raporti Career Direct report siguron depërtimin në modelin tuaj unik.

- Sesioni Një:**
- Përfaqse të mira dhe të këqija në zgjedhjen e karrierës
- Sesioni Dy:**
- Rishikimi i raportit personal– Seksioni mbi Personalitetin
- Sesioni Tre:**
- Rishikimi i raportit personal – Gjërat që bien më në pah në personalitetin tuaj
- Sesioni Katër:**
- Rishikimi i raportit personal – Pikat e forta/jo te forta të Personalitetit dhe si lidhen këto me karrierën tuaj
- Sesioni Pesë:**
- Rishikimi i raportit tuaj – Interesat, Grupet e përgjithshme të karrierës, si të kuptosh pikët që ke marrë
- Sesioni Gjashtë:**
- Rishikimi i raportit personal– Aftësitë dhe Zotësitë e tua
- Sesioni Shtatë:**
- Rishikimi i raportit personal – Vlerat: Ambienti i punës, Pritjet për punën, Vlerat e Jetës
- Sesioni Tetë:**
- Rezultat i lartë ose i ulët tek seksioni i Interesave

Mesazhi audio #4 – "Plani i Veprimit për të Ardhmen" (9 minuta)

Ky mesazh jep udhëzime specifike për plotësimin e planit tuaj të veprimit të personalizuar për të ardhmen.

- Sesioni Një:**
- Si të plotësosh Planin e Veprimit dhe ta përdorësh për drejtimin e karrierës.

Audio Files për Nxënësit/Studentët

"Plani i Veprimit për të Ardhmen - Paketa Arsimore" (17 minuta)

Ky mesazh jep udhëzime specifike për plotësimin e planit tuaj të veprimit të personalizuar për të ardhmen.

- Sesioni Një:**
- Si të plotësosh Planin e Veprimit dhe ta përdorësh në drejtimin e karrierës.
- Sesioni Dy:**
- Të zgjedhurit e degës së universitetit ose shtegut të karrierës

"Një mesazh për prindërit" (18 minuta)

Shënim: Baballarë dhe nëna - Duhet ta dëgjoni këtë seksion në mënyrë që t'i udhëzoni fëmijët tuaj në mënyrën më të mirë të mundshme.

- Sesioni Një:**
- Administrimi është më shumë se thjesht të bësh para
- Sesioni Dy:**
- Roli yt si trajneri i karrierës për studentin tuaj